

POLICY BRIEFS

KOSOVO



Konrad
Adenauer
Stiftung

Qershor 2015

www.kas.de/kosovo

ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME SA PËR STANDARDE

Visar Prebreza

Gazetar

PARATHËNIE

Energjia e ripërtëritshme është pjesa kryesore e këtij punimi. Por fillimisht do të ketë një pasqyrë të komplet sektorit të energjisë në Kosovë. Do të shohim vizionet e Qeverisë së Kosovës për energjetikën në 5 apo 10 vjetët e ardhshëm. Përmes këtyre vizioneve dhe ligjeve aktuale do të analizohet rëndësia që i është dhënë energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme jondotëse.

Të gjitha vendet e BE-së kanë marrë obligim që deri në vitin 2020 energjia e ripërtëritshme të marrë pjesë me 20 për qind në furnizimin final me energji elektrike. Për shumë shtete të zhvilluara ky cak i vendosur nuk paraqet problem, sepse ato tashmë e kanë prodhimin e energjisë së ripërtëritshme më shumë se 20 për qind. Në vendet e rajonit, Shqipëria qëndron më së miri sa i përket prodhimit të energjisë së pastër, pasi mbi 90 për qind e energjisë prodhohet nga hidrocentralet.

Kosova është vendi me më së shumti pasuri nëntokësore. Rrjedhimisht pasuria nëntokësore deri tani e ka determinuar edhe sistemin e energjisë, pasi mbi 90 për qind e energjisë së prodhuar është nga djegia e linjtit. E prodhimi i energjisë nga djegia e linjtit llogaritet se është një prej mënyrave më ndotëse të ambientit që përdoret për prodhimin e energjisë. Aktualisht "Kosova A", "Kosova B", Mihja e qymyrit dhe Depoja e hirit janë ndër ndotësitë më të mëdhenj të ambientit, sidomos të rrethinës së Prishtinës. Ndotja e ambientit nuk bëhet vetëm për faktin se aty digjet qymyri, por edhe për shkak të vjetërsisë së termocentraleve dhe mënyrës së punës në mihe.

Gjendja aktuale e ambientit në Kosovë, sidomos në rrethinën e Prishtinës, lë shumë për të dëshiruar. Termocentralet dhe veturat e vjetra kanë bërë që zona e kryeqytetit të jetë ndër më të ndoturat në tërë rajonin. Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për ndaljen e dëmtimit të ambientit, sidomos të ajrit. Në këtë vijë, në këtë punim do të shohim se cili është vizioni i Qeverisë për t'iu dhënë përparësi investimeve në energjinë e ripërtëritshme. Rritja e prodhimit në energji të ripërtëritshme do të ndikonte në uljen e nevojës për energji të prodhuar nga djegia e linjtit.

Krijimi i kushteve të favorshme për investime është i domosdoshëm për tërheqjen e kapitalit të huaj dhe atij vendor për të investuar në këtë sektor. E para, investimet në prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme do të kenë ndikim në zhvillimin

ekonomik, sepse vetëm me investime publike nuk mund të ketë zhvillim ekonomik. E dyta, krijimi i kushteve më të mira për investime në këtë fushë nënkupton ajër më të mirë dhe ruajtje të shëndetit. Dhe e fundit, Kosovës i është vënë obligim për anëtarësim në BE rritja e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

PASQYRA ENERGJETIKE E KOSOVËS

Kosova llogaritet se ka rezervat më të mëdha të linjtit në Evropë, që shtrihen në dy basenet më të mëdha, të emërtuara "Kosova" dhe "Dukagjini". Rezervat gjeologjike të linjtit janë vlerësuar të jenë rreth 12.5 miliardë tonë.¹ Në planin afatgjatë linjiti do të mbetet karburanti kryesor për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë.

Prodhimi i energjisë në Kosovë kryesisht është i bazuar në qymyr. Llogaritet se rreth 95 për qind e energjisë së prodhuar në Kosovë është nga termocentralet, të cilat djegin qymyr për të fituar energji. Sektori i energjisë elektrike në Kosovë është i dominuar nga KEK-u; përbëhet nga dy miniera të linjtit, në Bardh dhe Mirash, nga dy termocentrale me djegie të linjtit "Kosova A" dhe "Kosova B", me kapacitet të përgjithshëm efektiv prej rreth 1100 megavatesh. Djegia e linjtit për të prodhuar energji dhe vjetërsia e termocentraleve kanë bërë që prodhimi i energjisë në Kosovë të jetë me pasojë të mëdha për mjedisin.

Aktualisht vetëm rreth 5 për qind e energjisë së prodhuar në Kosovë vjen nga burimet e ripërtëritshme. Hidrocentrali i Ujëmanit tash për tash është i vetmi që kontribuon në furnizimin me energji elektrike. Në funksion janë edhe disa hidrocentrale të vogla (Lumëbardhi, Radaci, Dikanci dhe Burimi) që nuk prodhojnë më shumë se 10 megavat energji elektrike për orë.

Termocentralet aktuale nuk i përmbushin kriteret e BE-së për të vazhduar punën, për shkak të vjetërsisë së tyre. Termocentrali "Kosova A" tashmë e ka tejkaluar jetëgjatësinë normale. Ky termocentral ishte lëshuar në punë në vitet '60. Në bazë të obligimeve që Kosova ka marrë si nënshkruese e Traktatit të Energjisë, termocentrali "Kosova A" duhet të mbyllet më së largu deri më 31 dhjetor të vitit 2018. Kurse termocentrali "Kosova B" duhet të rivitalizohet, në mënyrë që t'i

¹ Strategjia e energjisë 2009-2018

arrijë kriteret e BE-së sa i përket ndotjes dhe emetimeve.

Strategjia e energjisë në Kosovë zakonisht është bërë për t'iu përshtatur politikave ditore. Madje, në disa raste pika tepër të rëndësishme janë vendosur në Strategji pa asnjë debat parlamentar e as debat publik. Kështu, Qeveria e Kosovës në kohën kur diskutohej për projektin "Kosova e Re" e kishte vendosur në Strategji që në pakon e Kosovës së Re të futen edhe mihjet e edhe Termocentrali "Kosova B".² Praktika e ngjashme ka vazhduar edhe në vitet pasuese.

Vitin e kaluar Qeveria e Kosovës e kishte hartuar draftstrategjinë e energjisë për të diskutuar me shoqërinë civile dhe me palët e interesit. Në draftstrategjinë e energjisë nuk ishte prezantuar asnjë shifër, por vetëm ishin vendosur disa orientime të përgjithshme.³ Pikërisht mungesa e të dhënave dhe e vizionit të qartë kanë qenë kritikata kryesore të shoqërisë civile. Mungesa e të dhënave ishte parë si një strategji e Qeverisë për t'i lënë vetes hapësirë për të ndryshuar projektet dhe madhësinë e tyre. Aktualisht Qeveria e Kosovës është në proces të hartimit të strategjisë së energjisë, e cila mund të kalojë në Kuvend për votim para muajit gusht. Strategjia e Qeverisë së re ende nuk është bërë publike.

VIZIONI ENERGETIK I KOSOVËS

Deri tani janë bërë disa strategji të energjisë, në të cilat ishte shpjeguar vizioni për këtë sektor. Këto strategji pothuajse asnjëherë nuk janë zbatuar, pasi projektet shpesh janë vazhduar pa u bazuar në strategji, dhe se deri tani nuk është realizuar asnjë nga projektet që janë iniciuar qysh në vitin 2006.⁴

Deri vonë vizioni energjetik ka qenë i betonuar sa i përket ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, duke u fokusuar vetëm në energjinë e prodhuar nga djegia e qymyrit. Në fillim Qeveria e Kosovës nuk i ka dhënë fare rëndësi energjisë së ripërtëritshme. Në

Strategjinë e vitit 2009 vetëm një faqe i kushtohet energjisë së ripërtëritshme, nga rreth 80 sosh. Qeveria në atë kohë kishte vendosur një cak, që deri në vitin 2016 rreth 7 për qind e energjisë të prodhohej nga burimet e ripërtëritshme.⁵ Shumëçka ka ndërruar pas caqeve që janë vendosur nga BE-ja për vendet nënshkruese të Traktatit të Energjisë.

Qeveria e Kosovës ka bërë plane që në një periudhë 10-vjeçare të mos jetë më importuese e energjisë elektrike. I është dhënë një rëndësi shumë më e madhe energjisë së ripërtëritshme, mirëpo sërish ajo kufizohet vetëm sa për t'i plotësuar caqet e vendosura nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, përkatësisht Komisioni Evropian. Meqë mungon një strategji e re dhe e qartë sa i përket vizionit energjetik, do të përdoren disa dokumente të miratuara nga Qeveria e Kosovës për të dhënë disa nga opsionet se sa do të jetë prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2024 dhe prej nga do të prodhohet ajo.

² Po aty

³ Draftstrategjia e energjisë

⁴ Në vitin 2006 ka nisur ideja për ndërtimin e termocentralit me kapacitet prej 2100 megavatesh. I njëjti nuk është realizuar asnjëherë, por është ndryshuar dhe po tentohet të jetësohet këtë vit, por me kapacitet prej vetëm 600 megavat. Në vitin 2009 janë bërë disa hapa për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit, por i njëjti nuk është diskutuar në publik tash e pesë vjet.

⁵ Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018, f. 76




Tabela 1- Vizioni i Qeverisë me Zhurin.
Burimi: Plani Zhvillimor i Transmisionit 2015-2024

Tabela që është bërë në bazë të vizionit energjetik që ka qenë deri në vitin 2014 parasheh që deri në vitin 2024, Kosova të ketë kapacitete të energjisë prej 1800 megavatesh. Në fakt, ky skenar është shumë optimist, pasi në vete ka paraparë që energjia e prodhuar nga burimet e energjisë së ripërtëritshme të jetë rreth 800 megavat. Deri tani për këtë vizion nuk është punuar, që i njëjti të jetë i realizueshëm, sepse ka ngecje në investimet në energjinë e ripërtëritshme dhe sidomos ka ndalje totale të projektit të Hidrocentralit Zhur.⁶ Kurse skenari konservativ i paraqitur nga institucionet e Kosovës e ul dukshëm energjinë që pritet të prodhohet nga burimet e ripërtëritshme. Pikërisht projekti i Zhurit hiqet nga vizioni konservativ.

⁶ Që nga viti 2010 nuk është mbajtur asnjë aktivitet për projektin e Hidrocentralit Zhur, bazuar në lajmet e publikuara në ueb-faqen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.




Tabela 2: Skenari pa Zhurin

Burimi: Plani Zhvillimor i Transmisionit 2015-2024

Mirëpo me ndërrimin e Qeverisë dhe me paraqitjen e kërkesave të reja nga investitorët për "Kosovën A" tashmë vizioni energjetik mund të pësojë ndryshime të mëdha. Deri tani Qeveria nuk ka marrë asnjë vendim sa i përket idesë për rindërtimin e termocentralit "Kosova A"⁷, për t'ia rritur kapacitetin në 800 megavat dhe për t'ia zgjatur jetën. Po ashtu, vizioni energjetik mund të ndikohet edhe nga projekti i gazit, që pritet të kalojë përmes Shqipërisë, sidomos projekti i kompanisë "Envedety", e cila ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës licenca për prodhimin e naftës sintetike nga djegia nëntokësore e qymyrit.⁸

Projekti kryesor në fushën e energjisë mbetet termocentrali "Kosova e Re" (Kosova C). Ndërtimi i këtij termocentralit ka qenë prioritet që nga viti 2006, por ai është anuluar e ndryshuar disa herë deri tani. Në dokumentet e projektit "Kosova e Re" thuhet se termocentrali i ri që pritet të ndërtohet në rrethinën e Obiliqit pritet të ketë kapacitet të instaluar prej 600 megavatesh.⁹ Kurse Qeveria e Kosovës tash synon që deri në vitin 2023 të ndërtojë kapacitete të reja gjeneruese prej 1200 megavatesh.¹⁰ Deri tani nuk

është dhënë asnjë shpjegim për këtë ndryshim kaq drastik në vizionin e Qeverisë së Kosovës.

Në programin e Qeverisë është ende projekti i Hidrocentralit të Zhurit, mirëpo i njëjti është vështirë i realizueshëm për shkak të lejeve që ka lëshuar Qeveria e Shqipërisë, që me të njëjtin ujë ka nisur ndërtimi i hidrocentraleve në anën e Shqipërisë.


⁷ Propozimprojekti i kompanisë "Bilffinger" për rindërtimin e termocentralit "Kosova A". Përveç zgjatjes së jetës, kjo kompani synon edhe t'ia rrisë kapacitetin në 815 megavat. Investimi në rindërtim pritet të jetë rreth 800 milionë euro.

⁸ "Koha Ditore", 30 prill 2015

⁹ Shih prezantimin e projektit në ueb-faqen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (<http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,202>)

¹⁰ Programi i Qeverisë 2015-2018

Vizioni Energjetik I Qeverise- 2023



Vizioni energjetik i kombinuar nga programi qeveritar dhe Udhëzimi Administrativ për caqet e vendosura për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme.¹¹


Mirëpo, nëse e marrim në kombinim një skenar konservativ, pa e përfshirë Hidrocentralin e Zhurit dhe sidomos duke e përfshirë një termocentral tjetër të ri, vërehet një dallim i madh. Duke marrë parasysh se shumë nga caqet e vendosura për prodhim të energjisë së ripërtëritshme nuk janë realizuar dhe ka vonesa në secilën prej shtyllave të prodhimit të energjisë.

Nevoja për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese rrjedh nga mungesa e vazhdueshme e energjisë elektrike për të mbuluar kërkesën. Furnizimi jostabil me energji elektrike ka dalë një nga hallet kryesore të bizneseve. Aktualisht prodhimi vendor i energjisë elektrike mund të shkojë deri në 110 megavat, mirëpo marrë parasysh jostabilitetin e prodhimit në "Kosovën A", KEK-u zakonisht operon vetëm me dy blloqe të kësaj njësie, kurse një tjetër e lë rezervë. Kërkesa për energji elektrike e tejkalon prodhimin vendor në disa pjesë të vitit. Kjo bën që Kosova të orientohet në importin e energjisë elektrike. Parashihet një rritje prej rreth 2.5 për qind e kërkesës për energji në 7 vjetët e ardhshëm, për të arritur kërkesa për energji elektrike në 1 mijë e 500 megavat në vitin 2022.¹²

¹¹ Të dhënat për BRE-në janë marrë nga Udhëzimi Administrativ për caqet e vendosura për prodhim të energjisë nga BRE-ja. Kurse të dhënat për termocentralet janë marrë nga programi qeveritar

¹² Balanca Afatgjatë e Energjisë e Republikës së Kosovës 2015-2024

Vizioni Energjetik bazuar në Programin Qeveritar - Pa Zhurin -2023



Përveç kësaj Përveç kësaj, në vizionin energjetik të Qeverisë për vitin 2023 kemi një ndryshim shumë të madh, pasi totali i kapaciteteve të prodhimit të energjisë që për bazë kanë linjitin arrin në 1800 megavat. Kjo do të bënte që Kosova të ketë serish shumicën e furnizimit me energji elektrike nga burimet ndotëse, siç është qymyri.

POTENCIALET E KOSOVËS PËR PRODHIMIN E ENERGISË SË RIPËRTËRITSHME

Janë bërë disa studime për potencialet e Kosovës për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme si: era, uji, dielli apo ato gjeotermale. Ka qëndrime të ndryshme sa u përket burimeve të ripërtëritshme. Qëndrimet janë bërë edhe më të thella, duke marrë parasysh se debati për dhe kundër energjisë së prodhuar nga qymyri është shndërruar në debat për dhe kundër energjisë së ripërtëritshme. Një pjesë e shoqërisë civile¹³ e kundërshton projektin "Kosova e Re" duke ofruar alternativa të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. E Qeveria e Kosovës për të dhënë argumente se ndërtimi i termocentralit të ri nuk ka alternativë shpesh ka dalë me deklarata e studime, me anë të të cilave është kundërshtuar dhe janë theksuar më shumë faktet kundër energjisë së ripërtëritshme.

Aktet nënligjore që janë miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik tregojnë se maksimumi që Kosova mund të arrijë deri në vitin 2020 është që të prodhojë rreth 765 megavat energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme.¹⁴ Energjia e prodhuar nga dielli (fotovoltaike) është paraparë që të startojë me 3 megavat në vitin 2014, për të pasuar me 4, përkatësisht 6 në dy vjetët pasues. Por aktualisht nuk prodhohen 4 megavat nga dielli, pasi vetëm këtë vit Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka miratuar tarifën nxitëse për këtë lloj të energjisë. Deri në vitin 2020, Qeveria pret që kapacitetet e energjisë së prodhuar nga dielli të jenë 10 megavat. Nga biomasa solide është paraparë prodhimi i 14 megavateve, kurse nga era plot 150 megavat. Studime të ndryshme që nuk janë bërë nga institucionet shtetërore thonë se në Kosovë kapacitetet e energjisë së prodhuar nga era mund të shkojnë deri në 288 megavat.¹⁵ Qeveria e Kosovës ka planifikuar që kapacitetet e HCV-ve të reja të arrijnë deri në 240 megavat, kurse aktualisht janë rreth 46.21 megavat kapacitetet e HCV-ve që janë në funksion. Në këtë parashikim është futur edhe Hidrocentrali i Zhurit me kapacitet prej 305 megavatesh.

¹³ KOSID-i ka prezantuar disa studime, me të cilat konstaton se Kosova ka potencial për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme sa për të zëvendësuar prodhimin aktual që bën "Kosova A".

¹⁴ Udhëzim Administrativ nr.01-2013 për caqet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë fq: 6

¹⁵ Studimi i bërë nga kompania "Evroenergie"

Shtojca I.

| Kapaciteti i Energjisë elektrike nga BRE (MW) | | | | | | | | |
|---|--------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| BRE-EE [MW] | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| Energjia fotovoltaike | | 3 | 4 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| Biomasë solide | | 2 | 4 | 6 | 8 | 10 | 12 | 14 |
| Era | 1.35 | 31.35 | 70 | 90 | 110 | 130 | 140 | 150 |
| Hydrocentrale të vogla ekzistuese | 46.21 | 46.21 | 46.21 | 46.21 | 46.21 | 46.21 | 46.21 | 46.21 |
| Hydrocentrale të vogla të reja | | 60 | 140 | 150 | 160 | 180 | 200 | 240 |
| Hydrocentrali Zhuri | | | | | 305 | 305 | 305 | 305 |
| Totali i kapacitetit | 47.56 | 142.56 | 264.21 | 298.21 | 636.21 | 679.21 | 712.21 | 765.21 |

Burimi: Udhëzim Administrativ nr.01-2013 për caqet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë

Përgjithësisht thuhet se burimet e ripërtëritshme të Kosovës janë të kufizuara dhe si të tilla nuk mund të garantojnë një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. Ky është arsyeja e zakonshme për të kundërshtuar koncentrimin në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Por, të paktën një studim i bërë nga një universitet amerikan ka konstatuar se vetëm nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë deri në vitin 2025 mund të prodhohen deri në 1200 megavat.¹⁶ Aktualisht Qeveria e Kosovës po synon t'i nxisë investimet në energji të ripërtëritshme vetëm sa për të plotësuar direktivat e BE-së. Kosova si nënshkruese e Komunitetit të Energjisë obligohet të përmbushë direktivat evropiane. Ndër direktivat që duhet përmbushur Kosova si nënshkruese e Traktatit është Direktiva 2004/EG, 2006/32/EG dhe Direktiva e fundit 2012/27/EU.¹⁷ Zbatimi i politikës 20-20-20¹⁸ është emëruesi i përbashkët i të gjitha këtyre direktivave.

PROJEKTET AKTUALE PËR PRODHIMIN E ENERGISË SË RIPËRTËRITSHME

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në periudhë gjashtëmuajore publikon të gjitha aplikacionet për autorizim dhe pranim në skemën mbështetëse për përfitimin e tarifave nxitëse. Deri tani ZRRE-ja ka lëshuar 6 autorizime finale, prej tyre: 3 hidrocentrale, 2 gjeneratorë me erë dhe 1 me panele fotovoltaike. Vetëm njëri prej tyre është në operim dhe ai nuk ka arritur të përfitojë tarifën nxitëse, pasi nuk ka instaluar gjeneratorë të rinj, por të përdorur.¹⁹ Në operim është edhe gjeneratori me panele fotovoltaike në Klinë me

kapacitet 102 kw. Kurse prej bizneseve që kanë pranuar autorizimin, Hydrocentrali në Deçan është në ndërtim e sipër, i cili pritet të ketë kapacitet 24 mw, përkatësisht 1 njësi prej rreth 9 mw, që pritet të futet në operim gjatë këtij viti dhe 2 njësi të tjera që pritet të futen në operim vitin e ardhshëm.²⁰ Në ndërtim e sipër është edhe Hydrocentrali në Dragash me kapacitet rreth 6 mw (2 njësi), Hydrocentrali në Lepenc, KK Shtërpçë, me kapacitet prej 4.6 mw, dhe Hydrocentrali në Shalë të Bajgorës (Dolac) me kapacitet prej 4.2 mw. Këto hidrocentrale në vitin 2016 pritet të nisin prodhimin e energjisë elektrike. Në total, kapacitete që janë në ndërtim e sipër janë rreth 40 megavat. ZRRE-ja ka pranuar 37 aplikacione për marrjen e autorizimeve preliminare për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme. Në total, këto aplikacione synojnë të ndërtojnë kapacitete të instaluar prej 462.83 megavatesh. (Shih aAneks 1)

PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA GJENERUESE

Në rregullën për aplikim për autorizim janë dhënë disa afate. Fillimisht ZRRE-ja ka të drejtë që brenda 60 ditësh të kërkojë nga aplikuesi që të sjellë dokumentacion shtesë rreth projektit. Pas paraqitjes së kërkesës për dokumentacion shtesë, investitorit i është lënë 15 ditë kohë për t'i sjellë dëshmitë e kërkuara nga ZRRE-ja, mirëpo ky afat mund edhe të prolongohet. E kur aplikacioni të kompletohet, ZRRE-ja duhet të kthejë një përgjigje brenda 90 ditëve. Edhe ky afat mund të prolongohet edhe për 30 ditë shtesë. Në total, nga data e aplikimit e deri në një vendim final të ZRRE-së mund të kalojnë 7 muaj.²¹ Por brenda këtij afati nuk nënkupton se mund të merret drita e gjelbër për fillimin e ndërtimeve.

Bazuar në rregullën e ZRRE-së, ky institucion mund të lëshojë autorizim final dhe autorizim preliminar. I pari nënkupton se menjëherë mund të nisin ndërtimet, kurse autorizimi preliminar kërkon plotësimin edhe të disa kushteve. Në këtë fazë është lënë plotësimi i

¹⁶ Shih: Daniel M. Kammen, Maryam Mozafari and Daniel Prull, "Sustainable Energy Options for Kosovo" http://ëëë.kosid.org/file/repository/Kammen_RAEL_Sustainable_Energy_Options_for_Kosovo_20_May_2012.pdf

¹⁷ Direktiva Evropiane për Energji Efiçiente (2012/27/EU), Udhëzues për implementim të fuqishëm,

<http://eedguidebook.energycoalition.eu/images/PDF/EED.pdf>

¹⁸ Kjo politikë parasheh që deri në vitin 2020 çdo shtet të ketë të paktën 20% e konsumit total energji e ripërtëritshme, 20% të kursehet nga efiçienca, dhe kjo të rezultojë me 20% zvogëlim i ndotjes së ambientit/gazrat CO2.

¹⁹ Për shkak të mospajtimeve me ZRRE-në, kompania "Wind Power" ka refuzuar që t'i lëshojë gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike për disa vjet.

²⁰ Intervistë e Afrim Ajvazit, udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit në ZRRE.

²¹ Rregulla e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, nenet: 11, 12 dhe 13.

kushteve më të vështira nga një investitor, e që kanë të bëjnë me shumë institucione. Në këtë fazë janë burokracia më e madhe dhe pengesa kryesore sa u përket investimeve në ndërtimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtëritshme. Ku, përveç të tjerash, kërkohet që të sillen: marrëveshja për përfshirjen në rrjet, leja për ndërtim, leja ujore në rast se kemi të bëjmë me hidrocentral, dhe projekti final i zbatimit.

Nga autorizimi preliminar deri në marrjen e autorizimit final mund të shkojë një procedurë prej 20 muajsh, duke përfshirë edhe katër muajt e tjerë që ZRRE-ja mund ta vonojë vendimin. Nga marrja e autorizimit, investitori i ka dy vjet kohë për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.²² Por ZRRE-ja ka lënë mundësi që afati i ndërtimit të prolongohet nga 2 deri në katër vjet. Në tërë procesin e lëshimit të autorizimit preliminar, ZRRE-ja e ka diskrecionin që t'u japë përparësi bizneseve që kanë arritur që të përfshihen në Skemën Mbështetëse²³ për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-ja, përkatësisht ato që kanë marrë tarifën nxitëse.

KUFIZIMI I INVESTIMEVE NË ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME

Institucionet e Kosovës i kanë kufizuar investimet në ndërtimin e kapaciteteve të reja të energjisë së pastër. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë kanë caktuar një cak për energjinë e domosdoshme që duhet të vijë nga energjia e ripërtëritshme. Ky cak i vendosur nga këto institucione njëkohësisht është edhe kufiri përtej të cilit BRE-ja nuk mund t'i gëzojë tarifën nxitëse. Fillimisht, MZHE-ja ka caktuar se sa duhet të jetë energjia e prodhuar nga BRE-ja që Kosova të zbatojë obligimet që dalin nga direktivat e BE-së. Këtë e ka bërë përmes një udhëzimi administrativ. Bazuar në këtë udhëzim, ZRRE-ja ka hartuar rregullat për skemën mbështetëse. Në këto rregulla janë përcaktuar të gjitha procedurat që duhet ndjekur që një biznes të përfshihet në skemën mbështetëse, përkatësisht mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Përfshirja në skemën mbështetëse nënkupton se ai biznes e gëzon tarifën nxitëse, që është e përcaktuar paraprakisht nga

ZRRE-ja. Ky grafik është marrë origjinal nga vendimi i ZRRE-së për tarifën nxitëse.²⁴

²² Po aty, fq 16, neni 16.

²³ Rregulla për skemën mbështetëse është miratuar në dhjetor të vitit 2014.

²⁴ Vendimi i ZRRE-së (V_673_2014), i datës 23 dhjetor 2014 për caktimin e tarifave nxitëse.

- V. Tarifat nxitëse (Feed-in) të përcaktuara për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë janë si në tabelën në vijim:

| Niveli i tarifave nxitëse i aplikueshëm për BRE | |
|---|---------|
| Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme | (€/MWh) |
| Energjia fotovoltaike | 136.4 |
| Biomasë solide | 71.3 |
| Era | 85.0 |
| Hydrocentrale të vogla të reja | 63.3 |

Tabela 2: Tarifat nxitëse të aplikueshme për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe të pranuar në Skemën Mbështetëse

Tarifat nxitëse janë dukshëm më të larta sesa tarifat që merr KEK-u aktualisht për energjinë e prodhuar në termocentrale.²⁵ Por, tarifat nxitëse për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme janë më të larta edhe se çmimi i importit të energjisë elektrike. Ndaj, çmimi i importit është i ndryshueshëm dhe varet kryekëput nga oferta që gjendet në treg, e cila determinohet nga kushtet atmosferike dhe nga niveli i prodhimit në rajon. Pra, operatorët që nuk përfshihen në skemën mbështetëse i nënshtrohen tregut të lirë, përkatësisht duhet të ketë çmimin sa energjia e prodhuar nga KEK-u, apo të eksportohet për çmim më të mirë.

| Kapaciteti i Energjisë elektrike nga BRE (MW) | | | | | | | | |
|---|------|-------|------|------|------|------|------|------|
| BRE-EE [MW] | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| Energjia fotovoltaike | | 3 | 4 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| Biomasë solide | | 2 | 4 | 6 | 8 | 10 | 12 | 14 |
| Era | 1.35 | 31.35 | 70 | 90 | 110 | 130 | 140 | 150 |
| Hydrocentrale të vogla të reja | | 60 | 140 | 150 | 160 | 180 | 200 | 240 |

Tabela 1: Kapacitetet e reja sipas caqeve për konsum nga burimet e ripërtëritshme të energjisë

²⁵ KEK-u merr 26.4 euro mesatarisht për një megavat që i shet me shumicë KEDS-it.

Nga grafiku që është marrë origjinal nga ZRRE-ja²⁶, del që totali i prodhimit të energjisë së ripërtëritshme që mund të jetë në funksion në vitin 2020 është rreth 414 megavat të instaluar. ZRRE-ja do t'i konsiderojë caqet e përmbushura atëherë kur do të lëshohen njoftimet mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar dhe Autorizimet Finale në kapacitetin e instaluar sipas Udhëzimit Administrativë nr. 01/2013 për caqet e BRE-së deri në vitin 2020.²⁷ Ky është kufizimi i vendosur nga institucionet e Kosovës, pasi kapacitetet e tjera që mund të ndërtohen nuk do të përfitojnë tarifën nxitëse. Aplikacionet që janë në shqyrtim e sipër në ZRRE e tejkalojnë kufizimin që është vendosur nga ZRRE-ja dhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Vetëm disa nga aplikacionet që janë dorëzuar në ZRRE janë përfshirë në skemën mbështetëse, për disa të tjera ZRRE-ja ende nuk ka marrë vendim.

Përfundimi dhe REKOMANDIMET

Sigurimi i furnizimit me energji elektrike është bërë shtyllë e çdo shteti, pasi konsiderohet si çështje e sigurisë nacionale. Energjia është një nga pikat kryesore dhe më të debatueshme edhe në mesin e politikës së jashtme të BE-së dhe të shteteve më të forta në botë. Kosova ende nuk i ka vënë themelet e energjetikës për të ardhmen. Termocentrali "Kosova B" duhet të rivitalizohet për t'iu zgjatur jeta deri në vitin 2030 apo 2040 në vartësi të investimeve që do të bëhen këto. Ndërkohë që "Kosova A" duhet të mbyllet (apo të rindërtohet nëse për këtë vendosin Qeveria e Kuvendi), kurse "Kosova e Re" ende nuk ka marrë formë.

Shumë studime e kanë thënë se Kosova aktualisht nuk mundet që ta zëvendësojë energjinë e prodhuar nga qymyri me energji të pastër, për shkak të kostos së lartë dhe mungesës së burimeve (si uji, era dhe dielli). Mirëpo, koncentrimi vetëm në energji të prodhuar nga qymyri po ashtu nuk është zgjidhje. Kosovës i duhet t'i maksimizojë investimet në energji të ripërtëritshme, sepse aktualisht jemi vendi i vetëm në rajon që mbi 90 për qind të energjisë së prodhuar e kemi nga djegia e linjtit.

Rregullat aktuale që janë vendosur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë i kufizojnë investimet në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme. Pamundësia për të përfituar nga tarifat nxitëse për shumë biznese do të jetë njëjtë si refuzim për të investuar në Kosovë, pasi me tarifat aktuale nuk është ekonomikisht i favorshëm investimi në këtë fazë.

Kur flitet për çmimet aktuale, prodhimi i energjisë elektrike nga djegia e qymyrit është më i lirë, duke mos marrë parasysh edhe eksternalitetet. Por kështu mund të mos jetë edhe në vitin 2025 ose 2030, pasi teknologjia e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme është duke u avancuar dhe mund të jetë më e lirë. Në mungesë të transparencës ende nuk dihet dallimi i çmimit të një megavati që prodhohet nga hidrocentralët dhe një megavati që do të prodhohet nga termocentrali i ri në vitin 2022.

- Qeveria e Kosovës duhet të vendosë caqe që synon t'i arrijë përtej vitit 2020, pra nuk duhet të kufizohet vetëm në kushtëzimin që ka marrë nga BE-ja. Caqet e vendosura nga Qeveria duhet të shkojnë të paktën deri në vitin 2024 apo 2030. Duke e bërë vizionin më afatgjatë, Qeveria e Kosovës u jep më shumë mundësi bizneseve për të investuar në BRE.
- Të hiqen kufizimet që janë vendosur për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Kjo bëhet përmes zgjatjes së vizionit të Qeverisë deri në vitin 2030.
- Futjen e të gjitha kapaciteteve që parashihen të ndërtohen deri në vitin 2030 në skemën mbështetëse. Rritja e përqindjes së energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, që do të mund të përfitojnë më shumë tarifa nxitëse dhe do të kemi më shumë investime në burimet të ripërtëritshme.
- Krijimi i One-Stop shop për energjinë që prodhohet nga burimet e ripërtëritshme, në mënyrë që investorët të mos obligohen të shkojnë në shumë institucione për t'i siguruar gjithë licencat dhe lejet e nevojshme për të nisur një investim për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme.
- Duhet që në kuadër të Strategjisë së re, energjia e ripërtëritshme të ketë një hapësirë të merituar, dhe në të cilën duhet të futen të gjitha studimet dhe strategjitë që janë bërë për sektorë të caktuar.

²⁶ Vendimi i ZRRE-së (V_673_2014), i datës 23 dhjetor 2014 për caktimin e tarifave nxitëse.

²⁷ Rregulla për skemën mbështetëse, neni 4, paragrafi I 7.

- Duhet të ketë transparencë më të madhe sa i përket çmimit të energjisë elektrike në vitin 2024. Përmes transparencës do të shihet nëse është e leverdishme që t'i jepet më shumë përparësi energjisë së ripërtëritshme.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Punimi origjinal është shkruar në gjuhën shqipe.

Rreth autorit

Visar Prebreza ka përfunduar fakultetin e Shkencave Politike, ndërsa është në fazën e fundit të studimeve Mastër, në drejtim "Menaxhment Biznes dhe Ekonomi". Që nga viti 2007 ka punuar si gazetar. Fillimisht në Kosova Sot, ndërsa që nga viti 2010 është gazetar në Kohën Ditore. Për tërë vitet ka qenë gazetar i ekonomisë dhe posaçërisht ka raportuar për gjitha ngjarjet në sektorin e energjisë. Prebreza ka fituar disa çmime për raportimet dhe hulumtimet e tij. Fitues i çmimit- Shkrimi më i mirë për ekonomi në vitin 2012, i cili është ndarë nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës dhe UNDP-ja. Fitues i çmimit të dytë për raportim për eficiencë të Energjisë. Fitues i çmimit "Vangjush Gambeta" në Shqipëri, për shkrimin më të mirë në Ekonomi në vitin 2014. Fitues i çmimit "RiPress " i ndarë nga instituti Riinvest, për artikullin më të mirë nga fusha e ekonomisë në vitin 2015. Pjesëmarrës në shumë konferenca dhe dëgjime publike për sektorin e ekonomisë, në veçanti atë të energjetikës. Ka qenë pjesëmarrës në Kongresin më të madh të gazetarisë në Evropë, përkatësisht në "European Newspaper Congress 2012" në Vjenë nga 6 deri më 8 Maj, 2012.

Kontakti:

Fondacioni Konrad Adenauer

Zyra në Kosovë

Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6

KO-10000/Pristina

Tel. +381 (0) 38 229 874

Prishtina@kas.de

www.kas.de/kosovo